



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 46 al. 2 të Ligjit për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 2/89), të nenit 3 të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe të nenit 19 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **30.09.2003** mori

V E N D I M

MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QENDRËS MEMORIALE TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi mbi caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Memoriale të UÇK-së në Prishtinë.

Neni 2

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Qendrës Memoriale të UÇK-së në Prishtinë.

Lokacioni nga alinea 1. e këtij neni, përfshinë pjesën e ngastrave kadastrale nr. 2602/2, 2603 të evidencuara në fletën poseduese nr. 3835 Komuna e Prishtinës dhe ngastrave kadastrale 2604, 2606, 2607, 2608, 2609, 2610/3, dhe 2610/22 të evidencuar në fletën poseduese 4137 KK Prishtinë me sipërfaqe të përgjithëshme rreth 2 hektarë, Komuna kadastrale Prishtinë, pronë e Komunës.

Neni 3

Ky Vendim paraqet bazë për hartimin e projektit urbanistik të lokacionit nga alinea 2 e nenit 2 e këtij Vendimi në bazë të të cilit do të caktohen kushtet urbanistike-teknike për lejimin e ndërtimit të objekteve investive nga neni 1 i këtij Vendimi.

Projekti urbanistik nga alinea 1 e këtij neni do të punohet nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës, sipas programit të prezentuar nga investitori.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve të Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtorati për Financa dhe Pronë të Komunës së Prishtinës do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre, të caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR.353-1725 DT. 06.10.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri